



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 376/1 Prot.

Tiranë, më 11 / 03 / 2019

V E N D I M

Nr. 39, Datë 11 / 03 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 148, datë 18.09.2018, të bërë nga E.V, kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash ka deklaruar se: *“Është punësuar pranë Albpetrol sh.a, Qendra e Administrimit të Ruajtjes Patos (QAR) në Njësinë e Shërbimit Special të Ruajtjes në datë 21.06.2014. Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të qershorit 2017 ka qenë komisioner në qendrën e votimit 3009 i propozuar nga subjekti politik, LSI. Pas këtyre zgjedhjeve ka filluar diskriminimi ndaj tij duke e kërcënuar me largim nga puna. Në datë 30.06.2017 e kanë transferuar si roje objekti në ndërmarrjen QAR duke mos respektuar kontratën e punës dhe një rënie në të ardhura prej 10.000 lekësh. Në datë 05.12.2017 është transferuar në ndërmarrjen Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës Patos (QASHN) me detyrë, punëtor shërbimi dhe paga e tij pësoi përsëri rënie në masën 7.000 lekë. Në datë 23.07.2018 është njoftuar me shkresën nr.6412, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Me datë 25.07.2018 i është drejtuar me një kërkesë ankesë administratorit për mënyrën jo transparente të vlerësimit nëpërmjet pikëzimit dhe vendit të punës. Me Vendimit nr.906, datë 29.10.2018 të Albpetrol sha, E.V është larguar nga puna”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike dhe ripunësimin e tij pranë Albpetrol sh.a.

¹ Karta anëtarësisë nr.27416, datë 09.10.2016, E.V është anëtar i subjektit politik, “Lëvizja Socialiste për Integrim” Fier. Referuar shkresës nr.1570/1, datë 03.12.2018 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, E.V ka qenë anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit nr.3009, në zgjedhjet e vitit 2017, i propozuar nga LSI.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr.148, datë 18.09.2018 të E.V u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1266/1, datë 20.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Albpetrol sh.a për ankesën e bërë nga E.V si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të strukturës së vjetër dhe strukturës së re të Q.A.SH.N Patos.
 - Cilat ishin kriteret e vendosura për pozicionin e punës, punëtor shërbimi, referuar strukturës së vjetër dhe të re?
 - Informacion mbi numrin e punonjësve të larguar (punëtor shërbimi) si pasojë e ristrukturimit dhe sa punonjës (punëtor shërbimi) ka aktualisht në Q.A.SH.N Patos.
 - Kopje të kontratës së punës të E.V.
 - Kopje të Librezës së Punës, arsimit, kualifikimit dhe vlerësimit të punës të E.V.
 - Kopje të procedurës së ndjekur nga ana e Albpetrol sh.a lidhur me ndryshimin e pozicioneve të punës dhe largimit nga puna të E.V.
 - Kopje e Listës së pikëzimit për punonjësit (punëtor shërbimi avarie) e Q.A.SH.N Patos.
 - Kopje të procesverbalëve të mbajtur për çdo punonjës (punëtor shërbimi avarie) të Q.A.SH.N Patos të kaluar në proces rivlerësimi.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën nr. 9040/1, datë 04.10.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albpetrol sh.a në mes të tjerash informoi se: *“E.V është punonjës i shoqërisë Albpetrol sh.a në pozicionin e punës “Punëtor Shërbimi Avarie” në Sektorin e Shërbimit pranë Qendrës së Administrimit dhe Shitjes së Naftës Patos. Gjatë vazhdimësisë së marrëdhënieve të punës me shoqërinë Albpetrol sh.a, E.V ka pasur ndryshime të pozicionit të punës me pëlqimin e tij paraprak dhe në bazë të dokumentacionit zyrtar që disponohet rezulton se ka qenë i punësuar si: - Specialist në Njësinë e Shërbimit Special pranë Qendrës së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës Patos nga data 21.06.2014 deri më datë 30.06.2017. – Roje objekti pranë Qendrës së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës Patos nga data 01.07.2017 deri më datë 05.12.2017. – Punëtor Shërbimi Avarie pranë Qendrës së Administrimit dhe Shitjes së Naftës Patos nga data 06.12.2017 dhe në vazhdim. Transferimi i E.V nga pozicioni i punës, Specialist në Njësinë e Shërbimit Special në Roje Objekti pranë QAR Patos, është kryer bazuar në kërkesën me shkrim nr. 330, datë 30.06.2017 të paraqitur nga E.V. Për sa i përket ndryshimit të pozicionit të punës nga “Roje Objekti” pranë QAR Patos në pozicionin e punës “Punëtor Shërbimi Avarie” pranë QASHN Patos, sqarohet se ka ardhur për shkak të mbylljes së pozicionit të punës Roje Objekti në QAR Patos”.*

Në vijim Albpetrol sha informon se, me Vendimin nr.503, datë 30.10.2017, shoqëria Albpetrol sh.a ka njoftuar E.V për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të mbylljes së vendit të punës “Roje objekti” pranë QAR Patos. Mbyllja e vendit të punës ishte rrjedhojë e zbatimit të Kontratës së Shërbimit me nr.1857/13, datë 02.05.2017, sipas së cilës një pjesë e shërbimit të ruajtjes e ofruar nga QAR Patos, do të mbulohej nga shërbimi privat. Të ndodhur në këto kushte si dhe duke marrë në konsideratë arsimin e E.V dhe faktin që në QASHN Patos ekzistonte një vend vakant “Punëtor Shërbimi Avarie” me pëlqimin paraprak të E.V është sistemuar në pozicionin përkatës të punës.

Për sa i përket ndryshimeve të pozicionit të punës të E.V, Albpetrol sh.a informon se nga verifikimet e kryera rezulton se E.V ka vazhduar ushtrimin e detyrës normalisht dhe nuk ka paraqitur asnjë ankesë kundër ndryshimeve të kryera, fakt i cili hedh poshtë çdo pretendim për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me vendim nr.8, datë 07.06.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të “Albpetrol” sh.a dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria Albpetrol sh.a është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv duke njoftuar punonjësit që preken nga ky proces. Në rastin konkret, sipas strukturës së re organizative të miratuar për Q.A.SH.N Patos, janë shkurtuar 3 vende pune “Punëtor Shërbimi Avarie” nga 5 të tilla të parashikuara në strukturën organizative të mëparshme. Punonjësit e prekur nga ky shkurtim i janë nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, sipas të cilit rezulton se E.V nuk përmbush kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Aktualisht, E.V është njoftuar me shkresën nr.6028, datë 17.07.2018 mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës.

Kriteret mbi të cilat është kryer përzgjedhja e punonjësve të QASHN Patos që u prekën nga pushimi kolektiv janë si më poshtë: - Arsimi, - Kualifikimi profesional/kategoria/patentë/licensë specifike, - Vjetërsia në punë.

Në përgjigje të shkresës së Albpetrol sh.a, ankuesi E.V, me shkresën datë 09.10.2018 në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Nuk ka hartuar ndonjë kërkesë për transferim pasi do kishte rënie të ndjeshme në pagë dhe transferimi do ishte në disfavorin e tij. Nga Albpetrol sh.a janë larguar 4 punonjës me detyrë punëtor shërbimi avarie dhe njëri është transferuar si shofer në QASHNG. Dy vendet e mbetura si punëtor nuk janë punësuar punonjës të cilët e kishin pozicionin “Punëtor Shërbimi Avarie” por persona të tjerë që janë transferuar në këto pozicione pune dhe konkretisht: G.B dhe P.H me detyrë axhustator janë transferuar si “Punëtor Shërbimi Avarie” pasi i përkasin subjektit politik,³ Partia Socialiste e Shqipërisë”.*

Me shkresën datë 05.11.2018, ankuesi E.V ka informuar Komisionerin se Albpetrol sh.a nuk i ka dhënë kopje të Vendimit nr.906, datë 29.10.2018 të largimit të tij nga puna.

Me e-mail-in datë 05.12.2018 ankuesi E.V ka dërguar pranë Komisionerit shkresën nr.1570/1, datë 03.12.2018 të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në të cilën shkruhet se: *“E.V me vendimin e KZAZ nr.58, Qarku Fier është emëruar anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit nr. 3009, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017, propozuar nga LSI”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr.148, datë 18.09.2018, Komisioneri me shkresën nr. 1266/5, datë 05.12.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.12.2018 duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Kopje të shkresës mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të E.V.
 - Kopje të Proces-Verbaleve, (Model-2) të veprimeve për vazhdimin e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për punonjësit e Repartit të Shërbimit&Oficinë për profesionet: Axhustator&Tubist (6 punonjës) dhe Punëtor Shërbimi (Avarie) (5 punonjës), me përjashtim të proces-verbaleve për punonjësit: T.G, E.V, A.Z dhe A.M.

Në seancë dëgjimore si përfaqësues të palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa, ishin prezent: Y.S dhe E.Ç përfaqësues të Shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe subjekti ankues, E.V.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Subjekti ankues parashtroi dhe një herë historikun e tij të marrëdhënieve të punësimit dhe pretendimin për diskriminim, ku theksoi faktin se gjatë procesit të vlerësimit dhe pikëzimit nga pesë punonjës që punonin në pozicionin e punës si punëtor shërbimi (avarie) një punonjës është punësuar si shofer (A.M) dhe nuk është mbajtur asnjë nga punonjësit e tjerë për dy vendet e punës por u mbajtën në punë dy punonjës që kishin punuar në pozicionin e punës

³ Referuar e-mail-it të E.V datë 02.10.2018.

axhustator&tubist dhe pikërisht P.H dhe G.B i cili i përket krahut politik të kundërt me të⁴. Në lidhje me pretendimet për ndryshimet e vendeve të punës, ankuesi tërhoqi pretendimet e tija duke deklaruar se do sqarohet dhe ai moment pasi ka kaluar shumë kohë⁵ por mohoi faktin e hartimit të kërkesës për ndryshimin e vendit të punës në datë 30.06.2017.

Nga ana e përfaqësuesve së Shoqërisë Albpetrol sh.a, u sqarua dhe njëherë se transferimi i E.V nga pozicioni i punës, Specialist në Njësinë e Shërbimit Special në Roje Objekti pranë QAR Patos, është kryer bazuar në kërkesën me shkrim nr. 330, datë 30.06.2017 të paraqitur nga E.V, ndërsa ndryshimi i pozicionit të punës nga “Roje Objekti” pranë QAR Patos në pozicionin e punës “Punëtor Shërbimi Avarie” pranë QASHN Patos, ka ardhur për shkak të mbylljes së pozicionit të punës “Roje Objekti” në QAR Patos por që në këtë rast është favorizuar E.V pasi nuk është larguar nga puna si kolegët e tjerë por u punësua në një pozicion tjetër.

Lidhur me ndryshimet e pozicioneve të punës të E.V, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a deklaruan se këto ndryshime kanë më shumë se një vit që kanë ndodhur dhe E.V ka vazhduar ushtrimin e detyrës normalisht dhe nuk ka paraqitur asnjë ankesë apo pretendim kundër ndryshimeve të kryera.

Lidhur me procesin e vlerësimit dhe të pikëzimit të punonjësve të repartit të shërbimit që do qëndronin në vendin e punës sipas strukturës së re, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a fillimisht deklaruan se procesi i vlerësimit është bërë për të gjithë punonjësit e repartit të shërbimit pavarësisht pozicioneve të punës por më vonë në vijim të seancës dëgjimore deklaruan se procesi i vlerësimit të punonjësve është bërë sipas pozicioneve të punës⁶ dhe për të faktuar këtë proces në ditët në vijim do të dërgonin, listën e punonjësve në pozicionet: punëtor shërbimi, axhustator dhe drejtues mjetesh sipas strukturës së vjetër dhe listën e këtyre punonjësve sipas strukturës së re, si dhe procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit të punonjësve të këtyre profesioneve me njëri-tjetrin.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, Komisioneri me shkresën nr.111, datë 22.01.2019 i është drejtuar Shoqërisë Albpetrol sh.a lidhur me kërkesën për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 13.12.2018.

Me e-mail-in datë 01.02.2019 Shoqëria Albpetrol sh.a ka dërguar pranë Komisionerit, kopje të shkresës nr. 863/1, datë 29.01.2019 drejtuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Kordinatorit të Platformës për Bashkëqeverisje në të cilën nuk sqarohet informacioni i kërkuar në seancën dëgjimore të datës 13.12.2018.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

⁴ Referuar deklaramit të bërë gjatë seancës dëgjimore nga ana e ankuesit, min 25 e rregjistrimit.

⁵ Referuar rregjistrimit të seancës dëgjimore, min 23.10 deri 23.40.

⁶ Referuar rregjistrimit të seancës dëgjimore min 29.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi lidhur me vlerësimin e tij në pushimin kolektiv nga puna, të ndërmarrë në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të Albpetrol sh.a.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 08, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a.i është nënshtruar procesit të ristrukturimit të saj, si rrjedhojë e të cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj Shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë Shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018.

Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450, fakt që konsiderohet si një pushim kolektiv me përmasa të mëdha.

Në pikën 02, të Vendimit nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018” parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njësisë të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6”*.

Në pikën 02, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave respektive.

Në kushtet kur fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe

Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive⁷ për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë që të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t'u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t'i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., si dhe Shtojcës 1 në vijim të kësaj Akt-Marrëveshjeje, kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t'i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit, që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën, se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Shoqëria Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a., “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë, numri i përgjithshëm i punonjësve të QASHN Patos është reduktuar me 31 punonjës, ndërsa në Repartin e Shërbimit të Sektorit të Naftës dhe Shërbimit është reduktuar numri i

⁷Kontrata Kolektive e Punës nr. 8781, datë 29.12.2017, lidhur ndërmjet Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH).

punonjësve me 9 të tillë. Referuar organikës aktuale të QASHN Patos⁸, në Repartin e Shërbimit, rezulton se janë shkurtuar vendet e punës, si më poshtë: Saldator, 1 vend pune nga 2, Axhustator & Tubist, 4 vende pune nga 6, Elektriçist, 1 vend pune nga 2 dhe Punëtor shërbimi (Avarie), 3 vende pune nga 5 (ku ishte i emëruar ankuesi).

Në referencë të përcaktimeve të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, Komisioni i vlerësimit pranë kësaj qendre ka vlerësuar me pikëzim punonjësit e repartit të shërbimit. Sikurse është përmendur edhe më sipër, kriteret mbi të cilat u krye vlerësimi me pikëzim, sipas urdhërit të sipërpërmendur ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Mbështetur në këto kriteret, duke iu referuar Proçesverbalit nr. 352/4, datë 06.07.2018 Model-3 dhe Proçes-verbaleve Model-2, rezulton se punonjësit për profesionet, axhustator dhe punëtor shërbimi janë vlerësuar të renditur sipas sasisë së pikëve, si më poshtë:

Axhustator&Tubist

1. F.B 80 pikë
2. V.Gj 80 pikë
3. D.M 80 pikë
4. **P.H 75 pikë**
5. A.S 75 pikë
6. **G.B 70 pikë**

Punëtor Shërbimi (Avarie)

1. M.Ll 55 pikë
2. T.G 50 pikë
3. A.Z 30 pikë
4. A.M 30 pikë
5. E.V 30 pikë

Mbështetur në sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. 6412, datë 23.07.2018, të Albpetrol, subjekti ankues është njoftuar se marrëdhëniet e punës mes tij dhe Shoqërisë Albpetrol sh.a do të ndërpriten me datë 28.09.2018, pasi referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, ai nuk plotësonte kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Ankuesi me shkresën Kërkesë-Ankesë, datë 25.07.2018 është ankuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës duke deklaruar se procesi i vlerësimit ka qenë jo transparent dhe i paracaktuar duke iu referuar punësimin të tij si axhustator dhe jo punëtor shërbimi.

Në përgjigje të ankesës së E.V, Albpetrol sh.a me shkresën nr.8503/1, datë 07.09.2018 ka informuar ankuesin se: *“Mbështetur në strukturën e re organizative të QASHN Patos, pozicioni Juaj i punës “Punëtor Shërbimi” është shkurtuar dhe për këtë shkak Ju jeni përfshirë në procesin e pikëzimit, së bashku me punonjësit e sektorit përkatës. Referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer, Ju rezultoni se nuk plotësoni kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës”.*

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se përzgjedhja e kryer nga Komisioni i Vlerësimit për 2 vende pune si Axhustator dhe 2 vende pune si Punëtor Shërbimi është bërë duke u mbështetur në tre kriteret e përcaktuara: Arsim, Kualifikim, Vjetërsi në punë.

⁸ Referuar shkresës nr. 5533/3, datë 02.07.2018, së Administratorit të “Albpetrol” sh.a. drejtuar QASHN Patos.

Në përfundim të këtij vlerësimi ka rezultuar se punonjësit axhustator: F.B, V.B dhe D.M kanë nga 80 pikë dhe A.S dhe P.H me nga 75 pikë, ndërsa renditja e punonjësve, punëtor shërbimi është: M.LI 55 pikë dhe T.G 50 pikë, ndërkohë që ankuesi E.V, A.Z dhe A.M rezultojnë me nga 30 pikë.

Në analizë të renditjes së përgjithshme të punonjësve sipas sasisë së pikëve, rezulton se fitues sipas pikëve të fituara për 2 pozicionet axhustator dhe 2 pozicionet punëtor shërbimi, duhet të ishin punonjësit: F.B, V.GJ, D.M me 80 pikë dhe një nga punonjësit A.S ose P.H me 75 pikë. Ndërsa nëse i referohemi renditjes së pikëve sipas pozicioneve të punës, fitues për 2 vendet punëtor shërbimi duhet të ishin punonjësit: M.LI me 55 pikë dhe T.G me 50 pikë.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues në të dy llojet e renditjeve nuk do rezultonte fitues, pasi është vlerësuar me 30 pikë, dhe gjykon se E.V nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a. krahasuar me punonjësit: P.H dhe G.B, të cilët qëndruan në vendet e punës në përfundim të procesit të vlerësimit.

Komisioneri, vlerëson se subjekti ankues nuk mund të krahasohet me punonjësit që pretendon se janë avantazhuar (P.H dhe G.B) pasi nuk është në kushte të njëjta me ta. P.H dhe G.B janë vlerësuar me më shumë pikë nga ana e Komisionit të Vlerësimit dhe ky ka qenë elementi që ka ndikuar në shpalljen e tyre si fitues në pozicionin “Punëtor Shërbimi”.

Pra, vetë ankuesi E.V nuk është në kushtet e vlerësimit me pikë të barabarta me punonjësit e tjerë, që të mund të merrej në konsideratë, për efekt krahasimor, elementi “bindja politike”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një

karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në analizë të tabelës së vlerësimit, Komisioneri konstaton se Komisioni i Vlerësimit ka bërë një vlerësim të pafavorshëm për punonjësit e tjerë të repartit të shërbimit të cilët janë vlerësuar me më shumë pikë se P.H dhe G.B dhe nuk kanë qëndruar në punë, por që ky vlerësim nuk ka ndikuar në marrëdhëniet e punësimit të ankuesit E.V, pasi ai rezultoi me 30 pikë që janë të pamjaftueshme për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit në pozicionin, punëtor shërbimi.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të pafavorshëm, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, në drejtim të punësimit të ankuesit E.V.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit E.V nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e dëgjimit.

KOMISIONERI

Robert GAJDA